



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1307/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren individuale Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit .... tani ... me .... me seli në Gjilan, rruga ...., të cilën e përfaqëson H.A, kundër debitorit ... tani ...., me NRB ...., me adresë ...., me seli në Gjilan të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat Ilir Rashiti nga Gjilani me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.257/19, i datës 12.03.2021, me datë 22.08.2022, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit ... tani ..., me NRB ..., me adresë rruga ...., me seli në Gjilan dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.257/19, i datës 12.03.2021.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar CP.nr.257/19, i datës 12.03.2021, ka vendosur të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit .... tani ...., me NRB ...., me adresë ...., me seli në Gjilan i paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr. 514/19, i datës 26.11.2019.

Kundër këtij aktvendimi me kohë ka parashtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike për çka i ka propozuar gjykatës se shkallës se dytë që ta aprovoi ankesën e debitorit dhe ta pezulloi aktvendimin mbi lejimin e përmbartimit, ta obligoj kreditorin ti paguaj shpenzimet lidhur me përpilimin e prapësimit në vlerë prej 208 euro, për

deponimin e pagesës prej 100 euro dhe 416 euro lidhur me përpilimin e ankesës sipas TAOK-ës.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

**-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori .... tani .... me NRB .... me seli në Gjilan, me datë 26.11.2019, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit .... tani ....., me NRB ....., me adresë ....., me seli në Gjilan në bazë të dokumentit të besueshëm- faturës me numër .... të datës 08.09.2017 dhe faturës me numër .... të datës 11.09.2019, me të cilën ka kërkuar që në emër të borxhit, t'ia paguajë shumën prej 10,062.42 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri.

Përmbareuesi Privat Kushtrim Musa me seli në Gjilan duke vepruar sipas propozimit për përmbaremore të kreditorit ka lejuar përmbaremoren me urdhrin P.nr. 514/19, i datës 26.11.2019, ndërsa kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datën 02.12.2019, duke theksuar se urdhri përmbaremore është bazuar në një dokument fiktiv dhe se faturat nuk janë origjinale ngase të njëjtat nuk janë nënshkruar nga debitori ku për më tepër i mungon edhe vula sepse të njëjtat janë lëshuar në emër të firmës, andaj ka shtuar se si të tilla nuk përbëjnë dokument të besueshëm. Ka shtuar tutje se faturat në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbaremore janë të pavlefshme pasi që të njëjtat janë fiktive nga numri i faturës shihet një mospërputhje nga fatura e parë me të dytën për një periudhë prej tre ditësh. Gjithashtu në prapësim ka deklaruar se faturat nuk janë të deklaruara në sistemin e ATK-së për cka një fakt i tillë duhet të vërtetohet nga kreditori, duke i propozuar gjykatës që ta aprovojë prapësimin e debitorit ta shfuqizojë urdhrin për lejimin e përmbaremore dhe ti anulojë të gjitha veprimet e ndërmarra përmbaremore.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 04.12.2019, duke theksuar se pretendimet e debitorit duhet të hedhen poshtë pasi që faturat janë origjinale të deklaruara në ATK dhe se pretendimet e debitorit janë të pa qëndrueshme ngase nuk ka prova për ti mbështetur pretendimet e tij, duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin e përmbaremore privat ta lejë në fuqi.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar

CP.nr.257/19, i datës 12.03.2021, ka vendosur që ta refuzoj prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se nuk janë plotësuar asnjëra nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, e po ashtu përmbaruesi privat e ka nxjerrë urdhrin përmbarimor në pajtim të plotë me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 pika 1.2, pasi që fatura paraqet dokument të besueshëm. Më tej ka theksuar se lidhur me pretendimet e debitorit se pa kurrfarë dokumenti përmbarimor është caktuar përmbarimi gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, pasi që nga shkresat e lëndës sic është fatura me numër .... të datës 08.09.2017 dhe fatura me numër .... të datës 11.09.2019, në bazë të cilave është nxjerrë urdhri përmbarimor në bazë të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, konsiderohen dokumente të besueshme në bazë të cilave mund të caktohet përmbarimi nga organi përmbarues. Ndërsa lidhur me pretendimet e debitorit se faturat janë fiktive, debitori është dashur ta provoj këtë fakt, ndërkohë që gjykata edhe këtë pretendim e ka konsideruar si të pabazuar pasi që një pretendim i tillë nuk hyn në grupin e shkaqeve të prapësimin të parapara me nenin 71 të LPP-së, andaj edhe ka vendosur që në kuptim të dispozitave të nenit 43, 73 pika 1, 2 dhe 3 të LPP-së, ta refuzojë prapësimin e debitorit si të pabazuar ndërsa urdhrin e përmbaruesit privat ta lejë në fuqi.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29 par 1.3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: faturat.

Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç janë fatura me numër .... të datës 08.09.2017 dhe fatura me numër .... të datës

11.09.2019, për shumën e detyrimit prej 10,062.42 Euro, dhe se i njëjti është i përshtatshëm për përmbnim pasi që përmban të gjitha kërkesat nga neni 29 paragrafi 1 dhe nën paragrafi 2 të LPP-së dhe janë të nënshkruara nga dy palët.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerësoi edhe pretendimin e debitorit lidhur me faktin se fatura e parë me faturën e dytë kanë një ndërprerje kohore prej tre ditësh sa i përket lëshimit të tyre, mirëpo kjo gjykatë gjeti se një fakt i tillë nuk është relevant për të vendosur ndryshe apo për ta liruar debitorin nga obligimi i marrë në bazë të faturave të sipërpërmendura.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1307/22, data 22.08.2022

Gjyqtarja  
Saranda Bogaj Sheremeti